



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e katërt, dt. 03.04.2008
Salla nr. N.225 ora 11,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Memli Krasniqi, Vlora Çitaku, Adem Hajdaraj, Fatmire Berisha, Donika Kadaj-Bujupi dhe Mark Krasniqi, ndërsa mungoi Arsim Rexhepi.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisioni

1. Procesvarbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.
2. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës

Kryetari i Komisionit kërkoi informatë nga referueset Drita Kadriu dhe Fatmire Berisha për punën e bërë në shqyrtimin e Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Drita Kadriu informoi të pranishmit se së bashku me anëtarin e Komisionit Fatmire Berisha kanë punuar në shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit.

Ajo kërkoi nga anëtarët e Komisionit që gjatë shqyrtimit të mëtejshëm të Projektligjit të mos lëshohemi në disa detaje si çështjet teknike dhe gjuhësore pasi lëshimet e tilla janë të shumta si dhe të bëhet harmonizimi dhe standardizimi i tekstit të projektligjit në të tri gjuhët.

Anëtarët e Komisionit filluan me amendamentimin e projektligjit dhe propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Preambula riformulohet::

“ Kuvendi Republikës së Kosovës

Në bazë të Kreut 5.1 (d) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001), Me qëllim të sigurimit të një kornize ligjore për rregullimin e Provimit Përfundimtar dhe provimit të maturës shtetërore në Kosovë,

Miraton:

Projektligjin për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore”.

Amendamenti 2

Titulli i projektligjit ndryshohet:

Projektligji për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore,

Ndryshimi vlenë në tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti 3

Te përkufizimet teksti “Kandidat” riformulohet:

“Kandidat” është nxënësi, vijuesi dhe personi i cili e përfundon me sukses klasën përfundimtare të arsimit të mesëm të lartë 12 ose 13.”

Në vazhdim në tërë tekstin e projektligjit përkufizimet dhe titujt shëndrrohen në njëjës.

Amendamenti 4

“Administruesit dhe vëzhguesit” fjala: **“testit”** zëvendësohet me fjalën: **“testimit”**

Amendamenti 5

Shtohet përkufizim i ri me këtë tekst:

”Test i standardizuar” është testi i përpiluar dhe bazhdaruar në pajtim me karakteristikat metrike të testeve që janë sajuar nga një institucion i profesionalizuar për hartimin e testeve të tilla.”

Amendamenti 6

Neni 3 pika 1 në fund të fjalisë shtohet teksti: **“varësisht nga profilet e caktuara”**

Amendamenti 7

Neni 5 pika 1 në fund të fjalisë shtohet teksti: **“sipas profilit të caktuar arsimor”**.

Amendamenti 8

Neni 6.1 teksti i nenit riformulohet përpilohet në njëjës:

“Kandidati i cili jashtë Kosovës ka marrë një dëftesë të barasvlershme me dëftesën e mbarimit të shkollës së mesme të lartë në Kosovë, e cila është e nostrifikuar, ka të drejtë të hyjë në provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore.

Amendamenti 9

Neni 6.2 riformulohet:

” Kandidati i kthyer i nënshtrohet provimit aty ku e cakton MASHT-i, bazuar në dokumentin e nostrifikuar për drejtimin përkatës në bashkëpunim me DKA”.

Amendamenti 10

Neni 8.2

Fjalja e dytë e tekstit të nenit në gjuhën serbe dhe angleze të fshihen.

Amendamenti 11

Neni 8.4 c) fjalët: **“1 dhjetor”** zëvendësohen me fjalët: **“31 dhjetor”**

Amendamenti 12

Neni 8.4 g) riformulohet:

”Publikon rezultatet e testit në marrëveshje me MASHT-in”.

Amendamenti 13

Neni 9 titulli i nenit **“Qendrën e vlerësimeve”** bëhet: **“Qendra e vlerësimit”**

Neni 9.2 fshihet

Amendamenti 14

Neni 9.3 d) të rishikohet me përfaqësuesit e ministrisë në mbledhjen e ardhshme.

Amendamenti 15

Neni 9.3 c) riformulohet:

”Mbikëqyr tërë procesin e zhvillimit të provimit të maturës, organizon dhe realizon vlerësimin e testeve dhe bën kontrollimin dhe përpilimin e të dhënave të kandidatëve”.

Amendamenti 16

Neni 9.3 h)

Fjala: **“zhvillon”** zëvendësohet me fjalën: **“procedon”**

Amendamenti 17

Neni 10.1 c) riformulohet:

“Siguron të dhënat e sakta dhe me kohë për kandidatët që do të vlerësohen përfshirë edhe kandidatët me nevoja të veçanta”.

Amendamenti 18
Neni 10.1 f) fshihet

Amendamenti 19
Neni 10.3 fshihen fjalët: **“me përgjegjësi”**.

Amendamenti 20
Neni 11.2 pas fjalëve: **“drejtori i shkollës”** shtohet teksti: **“ose personi i autorizuar nga ai”**.

Amendamenti 21
Neni 15 titulli i nenit riformulohet:
”Komisioni vlerësues i provimit përfundimtar”

Amendamenti 22
Neni 17.5 riformulohet:
“Vlera e pagesës për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore caktohet për çdo afat nga KQSHM”.

Amendamenti 23
Neni 18.1 b) riformulohet:
”Lëndët zgjedhore të përcaktuara varësisht nga tipi i gjimnazit”.

Amendamenti 24
Neni 19.2 fjalët: **“40%”** zëvendësohen me fjalët: **“50%”**

Amendamenti 25
Neni 19.5 a) dhe b) fshihet.

Amendamenti 26
Neni 27 a) riformulohet:
”Në shkallë të parë në Komisionin e vlerësimit të shkollës për provimin përfundimtar dhe për provimin e maturës shtetërore”.

Këto amendamente të propozuara Komisioni do t’i shqyrtojë në mbledhjen e ardhshme së bashku me përfaqësues të MASHT-it.

3. Të ndryshme

Mbledhja e ardhshme do të caktohet javën e ardhshme kur do të ftohet ministri i arsimit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 14,00

Kryetari i Komisionit,
Agim Veliu